

PHILIPS

Kufje

Seritë 8000

TAH8507



Manuali i Perdoruesit

Regjistroni produktin tuaj dhe përfitoni mbështetje në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme	2
	sigurie	2
	Siguria e dëgjimit	2
	Informacion i përgjithshëm	2
2	Kufjet tuaja Bluetooth over-ear	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Pajisje të tjera	3
	Vështrim i përgjithshëm për kufjet tuaja me valë Bluetooth	4
3	Fillo	5
	Ngarkoni baterinë	5
	Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular	5
4	Përdorni kufjet tuaja	6
	Lidhni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth	6
	Lidhja me tel	6
	Lidhje me shumë pika	6
	Lidhni kufjet me kompjuterin tuaj	7
	Menaxhoni telefonatat dhe muzikën tuaj	7
	Shkarkoni aplikacionin	8
5	Të dhënat teknike	9
6	Njoftim	10
	Deklarata e konformitetit	10
	Asgjësimi i produktit dhe baterisë tuaj të vjetër	10
	Hiqni baterinë e integruar	10
	Pajtueshmëria me EMF	10
	Informacion mjedisor	11
	Njoftimi i pajtueshmërisë	11
7	Markat tregtare	12
8	Pyetjet e bëra shpesh	13

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria e dëgjimit



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin e dëgjimit, kufizoni kohën e përdorimit të kufjeve me volum të lartë dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër duhet të jetë koha e sigurt e dëgjimit.

Sigurohuni që të respektoni udhëzimet e mëposhtme gjatë kohës që përdorni kufjet tuaja.

- Dëgjoni me volum të pranueshëm për periudha të arsyeshme kohore.
- Kini kujdes që të mos e ngrini vazhdimisht volumin gjatë kohës që dëgjimi juaj është duke u përshtatur.
- Mos e ngrini shumë volumin sa të mos dëgjoni as se çfarë bëhet rreth jush.
- Duhet të kini kujdes ose të ndërpritni përkohësisht përdorimin në situata potencialisht të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i zërit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- Nuk rekomandohet përdorimi i kufjeve me të dy veshët e zënë gjatë ngarjes së makinës dhe mund të jetë i paligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrimet nga muzika ose telefonatat kur jeni në trafik ose mjedisë të tjera potencialisht të rrezikshme.

Informacion i përgjithshëm

Për të shmangur dëmtimin ose mosfunksionimin:



Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet ndaj nxehtësisë së tepërt.
- Mos i hidhni kufjet në tokë.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj pikimit ose spërkatjes. (Referojuni vlerësimit IP të produktit specifik)
- Mos lejonit që kufjet tuaja të zhyten në ujë.
- Mos i karikoni kufjet kur lidhësi (konекtori) ose priza janë të lagura.
- Mos përdorni asnjë agjent pastrimi që përmban alkool, amoniak, benzen ose lëndë gërryese.
- Nëse lind nevoja për pastrim, përdorni një leckë të butë, nëse është e nevojshme të lagur me një sasi minimale uji ose sapun të butë të holluar, për të pastruar produktin.
- Bateria e integruar nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së tepërt si ndaj rrezeve të diellit, zjarrit ose të ngjashme me to.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar gabimisht. Zëvendësoni vetëm me të njëjtin lloj ose ekuivalent me të.
- Për të arritur vlerësimin specifik IP, kapaku i folesë së karikimit duhet të mbyllet.
- Hedhja e një baterie në zjarr ose në një furrë të nxehtë, ose shtypja ose prerja mekanike e një baterie, mund të rezultojë në një shpërthim.
- Lënia e një baterie në një mjedis rrethues me temperaturë jashtëzakonisht të lartë mund të rezultojë në një shpërthim ose rrjedhje të lëngut apo gazit të ndezshëm.
- Një bateri që i nënshtrohet presionit jashtëzakonisht të ulët të ajrit mund të rezultojë në një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të ndezshëm.
- Zëvendësimi i një baterie me një lloj të gabuar rrezikon të dëmtojë rëndë kufjet dhe baterinë (për shembull, në rastin e disa llojeve të baterive litium).

Lagështia dhe temperaturat e funksionimit dhe ruajtjes

- Ruajeni në një vend ku temperatura është midis -20°C dhe 50°C me lagështi relative deri në 90%.
- Vëreni në funksionim në një vend ku temperatura është ndërmjet 0°C dhe 45°C me lagështi relative deri në 90%.
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte të temperaturës së lartë ose të ulët.

2 Kufjet tuaja Bluetooth over-ear

Urime për blerjen tuaj dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistrojeni produktin tuaj në www.philips.com/support.

Me kufjet over-ear të Philips ju mund të:

- Argëtoheni me telefonatat e përshtatshme me valë pa përdorimin e duarve
- Shijoni dhe kontrolloni muzikën me valë
- Manovroni mes telefonatave dhe muzikës
- Gëzoni anulimin e zhurmës

Çfarë ka në kuti



Kufjet Philips me Bluetooth
Philips TAH8507



Kabllo karikimi USB (vetëm për karikim)



Kablloja audio



Adaptori për
aeroplan




Mikrofon i
rregullueshëm në
mbajtës



Pajisja dongle USB



Çanta mbajtëse



Udhëzues për
Fillimin e Shpejtë



Garancia Globale




Fletëpalosje sigurie

Pajisje të tjera

Një telefon celular ose pajisje (p.sh. kompiuter, tablet, përshtatës Bluetooth, lexues MP3 etj) që mbështet Bluetooth dhe është i pajtueshëm me kufjet (shih 'Të dhënat teknike' në faqen 9).

Vështrim i përgjithshëm për kufjet tuaja me valë Bluetooth



- ① Butoni i modalitetit ANC
- ② Butoni i Asistentit Zanor
- ③ Butoni i furnizimit me energji
- ④ USB-C
- ⑤ Treguesi LED
- ⑥ Foleja audio 2,5 mm / foleja e krahu i mikrofonit
- ⑦ Paneli me prekje
- ⑧ LED aktiv kur jeni i zënë
- ⑨ Krahu i mikrofonit i ngjithshëm
- ⑩ Butoni çift
- ⑪ Treguesi LED

3 Fillo

Ngarkoni baterinë

Shënim

- Përpara se të përdorni kufjet për herë të parë, karikoni baterinë për 2 orë për kapacitet dhe kohëzgjatje optimale të baterisë.
- Përdorni vetëm kabllon origjinal të karikimit USB për të shmangur çdo dëmtim.
- Përfundoni telefonatën tuaj përpara se të karikoni kufjet, duke qenë se lidhja e kufjeve për karikim do të fikë kufjet.

Lidhni kabllon e furnizuar të karikimit USB me:

- Vendin e karikimit USB të tipit C në kufje dhe;
- Karikuesin/portën USB të një kompjuteri.

↳ LED bëhet i bardhë gjatë karikimit dhe fiket kur kufjet ngarkohen plotësisht.

Këshillë

- Normalisht, një karikim i plotë kërkon 2 orë.

Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular

Përpara se të përdorni kufjet me telefonin tuaj celular për herë të parë, çiftotini ato me një celular. Një çiftim i suksesshëm krijon një lidhje unike të koduar midis kufjeve dhe telefonit celular. Kufjet ruajnë në memorie 4 pajisjet e fundit. Nëse përpigëni të çiftotni më shumë se 4 pajisje, pajisja e çiftuar në fillim (e para) zëvendësohet me një të re.

- 1 Sigurohuni që kufjet të jenë plotësisht të karikuara dhe të fikura.
- 2 Shtypeni dhe mbajeni të shtypur  për 5 sekonda derisa LED blu dhe i bardhë të pulsojnë në mënyrë alternative.
 - ↳ Kufjet qëndrojnë në modalitetin e çiftimit për 5 minuta
- 3 Sigurohuni që telefoni celular të jetë i ndezur dhe funksioni i tij Bluetooth të jetë i aktivizuar.
- 4 Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular. Për informacion të detajuar, referojuni manualit të përdorimit të telefonit tuaj celular.

Shembulli i mëposhtëm ju tregon se si të çiftotni kufjet me telefonin tuaj celular.

- ↳ Aktivizoni funksionin Bluetooth të telefonit tuaj celular, zgjidhni **Philips TAH8507**



Philips TAH8507

4 Përdorni kufjet tuaja

Lidhni kufjet me pajisjen tuaj Bluetooth

- 1 Aktivizoni telefonin tuaj celular/pajisjen Bluetooth.
- 2 Shtypeni dhe mbajeni t të shtypur butonin e ndezjes/fikjes për të ndezur kufjet.
 - ↳ LED i bardhë do të ndizet për 2 sekonda
 - ↳ Kufjet rilidhen automatikisht me celularin/pajisjen e fundit të lidhur me Bluetooth dhe në dongle



Këshillë

- Nëse ndizni celularin/pajisjen Bluetooth ose aktivizoni funksionin Bluetooth pasi të keni ndezur kufjet, duhet të rilidhni kufjet dhe pajisjen celulare/Bluetooth manualisht.



Shënim

- Nëse kufjet nuk arrijnë të lidhen me pajisjen e fundit Bluetooth të lidhur brenda 20 sekondave, ato do të kalojnë në modalitetin e lidhjes dhe më pas do të fiken automatikisht nëse nuk janë ende të lidhura me ndonjë pajisje Bluetooth 5 minuta më vonë.

Lidhja me tel

Është gjithashtu e mundur të përdoren kufjet me kabllon e dhënë të audios. Lidhni kabllon e dhënë të audios me kufjet dhe pajisjen e jashtme audio.

Lidhje me shumë pika

Çiftimi

- Çiftimi i kufjeve me dy pajisje, p.sh. celular dhe laptop

Kaloni nga një pajisje në tjetrën

- Muzika mund të riprodhohet në të njëjtën kohë vetëm nga njëra pajisje. Pajisja juaj e dytë do të rezervohet për telefonatat
- Ndaloni audion nga njëra pajisje për të nisur riprodhimin e audios në pajisjen tjetër




Shënim

- Marrja e një telefonate në pajisjen dy do të ndërpresë riprodhimin në pajisjen e parë. Telefonata do të drejtohet automatikisht në kufjet tuaja.
- Përfundimi i telefonatës do të rifillojë automatikisht riprodhimin nga pajisja një.

Lidhni kufjet me kompjuterin tuaj

- 1 Lidhni dongle në kompjuterin tuaj me USB-C ose USB-A me konvertues.



- 2 Ndizni kufjet, kompjuteri dhe kufjet tuaja do të lidhen automatikisht

Këshillë

- Dongle do të shfaqë LED blu të fortë kur lidhet.

Shënim

Për t'u rilidhur:

- a) Shkëputeni nga priza dhe vendosni pajisjen tuaj dongle në kompjuter dhe prisni që të lidhet automatikisht.

Ose

- b) Me dongle në portën USB të kompjuterit, shtypni butonin në dongle një herë për të nisur një lidhje me pajisjen tuaj.

Menaxhoni telefonatat dhe muzikën tuaj

Ndez/fik

Detyrë	Buton	Veprim
Ndizni kufjet	Butoni i furnizimit me energji	Shtypeni dhe mbajeni shtypur për 2 sekonda
Fikni kufjet	Butoni i furnizimit me energji	Shtypeni dhe mbajeni shtypur për 2 sekonda ↳ LED i bardhë është ndezur dhe fiket

Kontrolli i muzikës

Detyrë	Buton	Veprim
Luaj ose ndalo muzikën	Pad me Prekje	Prekni 2 herë
Rregulloni volumnin	Pad me Prekje	Rrëshqitni lart/ Rrëshqitni poshtë
Kënga tjetër	Pad me Prekje	Rrëshqitni përpara
Kënga e mëparshme	Pad me Prekje	Rrëshqitni prapa

Kontrolli i thirrjeve telefonike

Detyrë	Buton	Veprim
Ngri një telefonatë	Pad me Prekje	Prekni 2 herë
Refuzo/mbyll një telefonatë	Pad me Prekje	Prek 1 sekondë
Përgjigju thirrjes së re telefonike gjatë një telefonate	Pad me Prekje	Prekni 2 herë
Refuzo thirrjen e re telefonike gjatë një telefonate	Pad me Prekje	Prek 1 sekondë
Ndërro thirrjen kur ju përgjigjesh dy telefonatave	Pad me Prekje	Prekni 2 herë

Kontrolli i ANC

Detyrë	Buton	Veprim
ANC NDEZUR/ Modaliteti i ndërgjegjësimit/ANC FIKUR	Butoni i modalitetit ANC	Shtypni një herë

Modaliteti i ndërgjegjësimit

Detyrë	Buton	Veprim
Modaliteti i ndërgjegjësimit	Butoni i modalitetit ANC	Shtypni derisa të dëgjoni "Awareness on" ("Ndërgjegjësimi ndezur")
Bisedë e shpejtë	Pad me Prekje	Cekni me pëllëmbë mbi kupën e veshit të djathtë

Funksioni i ndihmës zanore të telefonit inteligjent (p.sh. aplikacioni Google, Siri)

Detyrë	Buton	Veprim
Funksioni i ndihmës zanore të zgjimit të telefonit inteligjent	Butoni i Asistentit Zanor	Shtypni një herë

Shënim

- Ju lutem referojuni udhëzimeve të përdorimit të telefonit inteligjent.

Statusi i treguesit të kufjeve të tjera

Statusi i kufjeve	Treguesi
Kufjet janë gati për çiftim	LED pulson në ngjyrë blu dhe të bardhë në mënyrë alternative
Kufjet janë të ndezura, por nuk janë të lidhura me një pajisje Bluetooth	LED blu pulson një herë në 7 sekonda. Nëse nuk mund të realizohet lidhja, kufjet do të fiken vetë brenda 5 minutash
Niveli i ulët i baterisë	Drita LED e bardhë pulson ngadalë derisa të mbarojë bateria
Bateria është plotësisht e ngarkuar	LED i bardhë është i fikur
Kufjet janë në modalitetin e telefonatës	LED i kuq i zënë do të pulsojë

Shkarkoni aplikacionin

Skanoni kodin QR/shtypni butonin "Shkarko" ose kërkoni "Philips Headphones" në Apple App Store ose Google Play për të shkarkuar aplikacionin.



Aplikacioni i Philips Headphones ju jep kontrollin e muzikës që jeni duke dëgjuar. Mund ta personalizoni tingullin në mënyrë që përvoja juaj e muzikës dhe e telefonatave t'i përshtatet gjithmonë nevojave tuaja.

5 Të dhënat teknike

Kufje

- Koha e riprodhimit të muzikës (ANC fikur): deri në 55 orë
- Koha e riprodhimit të muzikës (ANC ndezur): deri në 45 orë
- Koha e karikimit: 2 orë
- Bateri litium-jon e rikarikueshme (800 mAh)
- Versioni i Bluetooth: 5.0
- Profilet e përputhshme Bluetooth:
 - HFP (Profil pa përdorimin e duarve)
 - A2DP (Profil i përparuar i shpërndarjes së audios)
 - AVRCP (Profili i telekomandës audio video)
- Rrezja e frekuencës: 2,402-2,480GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Rrezja e veprimit: Deri në 10 metra
- Reduktimi i jehonës dhe zhurmës dixhitale
- Fikja automatike e mbyllur
- Lloji –C i portës USB për karikim
- Mbështet AAC dhe SBC



Shënim

- Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim.
- Kohëzgjatja e baterisë gjatë kohës së riprodhimit është e përafërt dhe mund të ndryshojë në varësi të kushteve të aplikimit.

6 Njoftim

Deklarata e konformitetit

Nëpërmjet këtij dokumenti, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat bazë dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës RED 2014/53/EU dhe UK Radio Equipment Regulations SI 2017 No 1206. Deklarata e Konformitetit mund të gjendet në www.philips.com/support.

Asgjësimi i produktit dhe baterisë tuaj të vjetër



Produkti juaj është konceptuar dhe prodhuar me materiale dhe përbërës të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol në një produkt do të thotë që produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol nënkupton që produkti përmban një bateri të integruar të rikarikueshme të mbuluar nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU, e cila nuk mund të hidhet me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Ne ju këshillojmë fuqimisht ta çoni produktin tuaj në një pikë zyrtare grumbullimi ose në një qendër shërbimi Philips për të hequr në mënyrë profesionalei baterinë e rikarikueshme. Informohuni për sistemin lokal të grumbullimit të veçantë për produktet elektrike dhe elektronike dhe bateritë e rikarikueshme. Ndiqni rregullat lokale dhe mos e hidhni kurrë produktin dhe bateritë e rikarikueshme me mbeturinat e zakonshme shtëpiake.

Asgjësimi i duhur e produkteve të vjetra dhe baterive të rikarikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Hiqni baterinë e integruar

Nëse nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produktet elektronike në vendin tuaj, mund ta mbronni mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë përpara se të hidhni kufjet e fiksuara në vesh.

- Sigurohuni që kufjet të jenë shkëputur nga kutia e karikimit përpara se të hiqni baterinë.



Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt përputhet me të gjitha standardet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Informacion mjedisor

Janë hequr të gjitha paketimet e panevojshme. Jemi munduar që paketimi të ndahet lehtësisht në tre materiale: karton (kuti), shkumë polistireni (amortizator) dhe polietilen (qese, fletë shkumë mbrojtëse). Sistemi juaj përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të shteruara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftimi i pajtueshmërisë

Pajisja përputhet me rregullat e FCC, Pjesa 15. Funksionimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje mund të mos shkaktojë ndërhyrje të dëmshme dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje të marrë, duke përfshirë ndërhyrjen që mund të shkaktojë funksionim të padëshiruar.

Rregullat e FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është gjetur se përputhet me kufizimet për një pajisje dixhitale të Klasit B, në përputhje me pjesën 15 të Rregullave FCC. Këto kufizime janë krijuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme në një instalim banese. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuece dhe, nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me manualin e udhëzimeve, mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme në komunikimet radio. Sidoqoftë, nuk ka asnjë garanci që nuk do të ketë ndërhyrje në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton ndërhyrje të dëmshme në radio ose nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me manualin e udhëzimeve, mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme në komunikimet me radio.

Sidoqoftë, nuk ka asnjë garanci që nuk do të ketë ndërhyrje në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton ndërhyrje të dëmshme në marrjen e radios ose televizionit, e cila mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi inkurajohet të përpiqet për korrigjimin e ndërhyrjes duke përdorur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Riorientoni ose zhvendosni antenën marrëse.
- Rritni nivelin e ndarjes ndërmjet pajisjes dhe marrësit.
- Futeni pajisjen në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me tregtarin ose një teknik me përvojë radio/TV për ndihmë.

Deklarata e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje përputhet me limitet e ekspozimit ndaj rrezatimit FCC të përcaktuara për një mjedis të pakontrolluar. Ky transmetues nuk duhet të bashkëvendoset ose të përdoret në lidhje me ndonjë antenë ose transmetues tjetër.

Kujdes: Përdoruesi paralajmërohet se ndryshimet ose modifikimet që nuk miratohen shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund të anulojnë autoritetin e përdoruesit për të përdorur pajisjen.

Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licenca që përputhen me përjashtimin nga licenca për Inovacionin, Shkencën dhe Zhvillimin Ekonomik të Kanadasë. Funksionimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje s'mund të shkaktojë interferencë. (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë, duke përfshirë edhe interferencën që mund të shkaktojë funksionim të padëshiruar të pajisjes.

L'émetteur/récepteur exempt de licence contenu dans le présent appareil est conforme aux CNR d'Innovation, Sciences et Développement économique Canada applicables aux appareils radio exempts de licence. L'exploitation est autorisée aux deux conditions suivantes : (1) L'appareil ne doit pas produire de brouillage; (2) L'appareil doit accepter tout brouillage radioélectrique subi, même si le brouillage est susceptible d'en compromettre le fonctionnement.

CAN ICES-003(B)/NMB-003(B)

Deklarata IC e ekspozimit ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje përputhet me limitet kanadeze të ekspozimit ndaj rrezatimit të përcaktuara për mjedise të pakontrolluara.

Ky transmetues nuk duhet të bashkëvendoset ose të përdoret në lidhje me ndonjë antenë ose transmetues tjetër.

7 Markat tregtare

Bluetooth

Marka e fjalës dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga Top Victory Investment Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës.

Siri

Siri është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe vende të tjera.

Google

Google është një markë tregtare e Google LLC.

Asistenti i Google nuk ofrohet në gjuhë dhe vende të caktuara.

8 Pyetjet e bëra shpesh

Kufjet e mia Bluetooth nuk ndizen.
Niveli i baterisë është i ulët. Ngarkoni kufjet.

Nuk mund t'i çiftoj kufjet e mia Bluetooth me pajisjen time Bluetooth.
Bluetooth-i është i çaktivizuar. Aktivizoni funksionin Bluetooth në pajisjen tuaj Bluetooth dhe ndizni pajisjen Bluetooth përpara se të hapni kufjet.

Si të rivendosni çiftimin.
Shtypni dhe mbani të shtypur dy butonat Power (Energji) + ANC për 3 sekonda, LED ndizet blu dhe më pas LED-et blu dhe të bardhë pulsojnë në mënyrë alternative.

Mund të dëgjoj, por nuk mund ta kontrolloj muzikën në pajisjen time Bluetooth (p.sh. luaj/pauzë/kalim përpara/prapa).

Sigurohuni që burimi audio Bluetooth të mbështesë AVRCP (shih 'Të dhënat teknike' në faqen 9).

Niveli i volumit të kufjeve është shumë i ulët.

Disa pajisje Bluetooth nuk mund të lidhin nivelin e volumit me kufjet përmes sinkronizimit të volumit. Në këtë rast, duhet të rregulloni volumnin në pajisjen tuaj Bluetooth në mënyrë të pavarur për të arritur nivelin e kërkuar të volumit.

Pajisja Bluetooth nuk mund t'i gjejë kufjet.

- Kufjet mund të lidhen me një pajisje të çiftuar më parë. Fikni pajisjen e lidhur ose zhvendoseni atë jashtë rrezes së veprimit.
- Funksioni i çiftimit mund të jetë rivendosur ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftoni sërish kufjet me pajisjen Bluetooth siç përshkruhet në manualin e përdorimit. (shihni "Çiftoni kufjet me telefonin tuaj celular" në faqen 5).

Kufjet e mia Bluetooth janë të lidhura me një telefon celular me stereo Bluetooth, por muzika luhet vetëm në altoparlantin e telefonit celular.
Referojuni manualit të përdorimit të telefonit tuaj celular. Zgjidhni për të dëgjuar muzikë përmes kufjeve.

Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohet një zhurmë kërcitjeje.

- Pajisja Bluetooth është jashtë rrezes. Zvogëloni distancën ndërmjet kufjeve dhe pajisjes Bluetooth ose hiqni pengesat midis tyre.
- Karikoni kufjet tuaja.

Rivendos çiftimin e pajisjes dongle.

- Lidhni pajisjen dongle në kompjuterin tuaj.
- Në dongle, shtypni dhe mbani të shtypur butonin "Çifto" për 2 sekonda derisa drita LED blu dhe e bardhë të pulsojë në mënyrë alternative.
- Në kufje, shtypni dhe mbani të shtypur  për 5 sekonda derisa LED blu dhe e bardhë të pulsojë në mënyrë alternative.
- Shpejt, dongle dhe kufjet do të çiftohen automatikisht.
- Kur çiftohen me sukses, LED do të bëhet blu.

Për mbështetje të mëtejshme, vizitoni www.philips.com/support.



2021 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim. Philips dhe stema Philips Shield janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt. Të gjithë emrat e tjerë të kompanive dhe produkteve mund të jenë marka tregtare të kompanive të saj përkatëse me të cilat janë të lidhura.

